

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1315 Prot.

Tiranë, më 28.12 2016

VENDIM Nr. 153, datë 20.12.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "*Për Trashëgiminë Kulturore*" (i ndryshuar), VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 "*Për përcaktimin e kritereve, procedurave të dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje*" pika 4/d, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.14, të datës 20.12.2016 pasi shqyrtoi *Kërkesën e ALUIZNI Durrës, për konfirmim nga KKA*, për vijimin e procedurës së legalizimit të shtesave anësore dhe katit pa leje ndërtimi, në objektin me leje ndërtimi të subjektit SH.P.K."Durrës 2000", i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Kërkesën e ALUIZNI Durrës, për konfirmim nga KKA*, për vijimin e procedurës së legalizimit të shtesave anësore dhe katit pa leje ndërtimi, në objektin me leje ndërtimi të subjektit SH.P.K."Durrës 2000", i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO